




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0061628-10/24 dt. 23.09.2024
Mitrovicë



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 2, pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 2, paragrafi 5, të Rregullores (MF) Nr. 04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve; nenit 13, paragrafi 1, pika 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 3 paragrafi 3 dhe 4 i Rregullore Komunale Nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 23.09.2024; sjell këtë:

VENDIM

Për mbështetje financiare (subvencionim) të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së

1. MIRATOHET Kërkesa Nr. 02-453/01-0054173/24 dt. 12.08.2024 e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë për mbështetje financiare.
2. Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – dega në Mitrovicë mbështetet me mjete financiare prej 3,300.00 (tremijetreqind) € nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere – Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
3. Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të barten në xhirollogarinë e shoqatës së lartpërmendur.
4. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

